



|                                                                                            |            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA                                |            |
| QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA                                    |            |
| Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister                       |            |
| Agjencia për Barazi Gjinore - Agencija za Polnu Ravnopravnost - Agency for Gender Equality |            |
| Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot. No.                                                        | 347/2022   |
| Data:<br>Datum:<br>Date:                                                                   | 01/08/2022 |
| Prishtinë/Priština/Prishtina                                                               |            |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

ZYRA E KRYEMINISTRIT / OFFICE OF THE PRIME MINISTER / URED  
PREMIJERA

AGJENCIA PER BARAZI GJINORE / AGENCIJA ZA RAVNOPRAVNOST  
POLOVA / AGENCY OF GENDER EQUALITY

Datë: 01/08/2022

#### RAPORT

**Implementimi i thirrjes publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve të OJQ-ve që kontribuojnë në :**

- 1)Hulumtimin për situatën e grave dhe vajzave ne sport,përmes analizës se: buxhetit të sportit me ndjeshmëri gjinore, analizës se stereotipeve gjinore që mund të pengojnë qasjen e grave dhe vajzave ne sport.
- 2)Analizën e situatës nga aspekti gjinor i pozitës se grave të dënuara për dhunën ne familje duke përfshi politikat ndëshkimore për rastet r grave-dhunuese.
- 3)Realizimi i hulumtimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave ne pozitë vendimmarrëse ne sektorin publik dhe privat.

#### Hyrje

Agjencia për Barazi Gjinore ka bërë thirrje publike me 08.07.2022 për financim të projekteve të OJQ-ve në zbatim të drejtpërdrejtë të Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe Planit të Veprimit 2020-2024, respektivisht analizave gjinore dhe hulumtimeve që analizojnë gjendjen e grave dhe burrave sipas objektivave Strategjike

Shtylla II: Zhvillimi Njerëzor, Rolet dhe Marrëdhëniet Gjinore

Shtylla III: Te drejtat e grave ,qasja ne drejtësi dhe siguria.

Agjencia për Barazi Gjinore ka realizuar këtë thirrje publike duke respektuar standardet me të larta të konkurrencës, transparencës dhe vendim marrjes në përputhje me rregulloren

MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Në kuadër të kësaj thirrje publike Agjencia për Barazi Gjinore ka pranuar aplikimet e gjithsej 7 Organizata Jo Qeveritare të cilat para vlerësimit të projekteve të tyre komisioni ka bërë kontrollin administrativ të secilit aplikacion.

Lista e të gjithë aplikantëve (OJQ-ve) që kanë aplikuar në kuadër të kësaj thirrje publike janë:

1. OJQ – SIT – Kadri Gashi. Emri I projektit Analize per denimet e shqiptuara per kryesit/et e veprave te dhunes ne Familje ne kuader te projektit Keshillim per parandalim dhe Rehabilitim.
2. INSTITUTI I KOSOVES PER REND DHE LIGJ – Florije Burjani.Emri I projektit:Hulumtim,Hartim Doracakut,Trajnim dhe Prandalim I Abuzimit dhe Keqperdorimit te Vajzave dhe Grave.
3. OJQ –ALTERNATIVA RINORE .Donjeta Sadiku.Emri I Projektit:”Integrimi gjinor dhe perfshirja e grave ne tregun e punes dhe vendimmarrje”
4. INSTITUTI RIINVEST. Saxhide Mustafa.Emri I projektit:Roli I grave ne vendimmarrje ne sektorin public dhe privat ne Kosove”
5. LEADERSHIP DEVELOPMENT ASSOCIATION ALBANIAN .Qendrim Hoxha.Emri I projektit “Hulumtim rreth perfshirjes se grave ne vendimmarje ne insitucionet publike te regjionit Ferizaj”
6. QENDRA KOSOVARE PER STUDIME GJINORE. Luljeta Demolli.Grate dhe Vajzat ne fushen e sportit:hulumtim mbi stereotipet gjinore dhe barrierat qe pengojne qasjen e barabarte ne sport.
7. DEMOKRACIA PLUS (D+).Valmir Ismaili .Emri I projektit: Realizimi I hulumtimit per perfaqesimin e grave dhe vajzave ne pozitat vendimmarrese ne sektorin publik dhe privat .


#### Vlerësimi

Agjencia për Barazi Gjinore ka themeluar Komisionin vlerësues me nr të vendimit 268/2022 i përberë nga 3 zyrtar të ABGJ-së dhe dy anëtar/e përfaqësues nga Shoqëria Civile gjegjësisht ekspert të jashtëm, kishte për detyrë të vlerësoj të gjitha aplikacionet e paraqitura në kuadër të thirrjes publike.

Komisioni Vlerësues i themeluar sipas thirrjes dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores MF-Nr. 04/2017, në prezencë të të gjithë anëtarëve ka bërë hapjen dhe vlerësimin e çdo aplikacioni dhe sipas thirrjes publike dhe kriterëve; a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike të cilat ishin baza për kualifikim të aplikantëve për mbështetje publike financiare sipas neneve 10 dhe 11 të rregullores MF-Nr.04/2017, komisioni ka vlerësuar dhe ka ardhur në përfundim se vetëm "Qendra Kosovare për Studime Gjinore(QKSGJ)" ka plotësuar në tërësi kriteret e parapara me nenin 10 dhe 11 të Rregullores MF-Nr.04/2017 kriteret e thirrjes publike; a) kriteret e përgjithshme dhe b) kriteret specifike dhe si e tillë kualifikohet për financim.

#### Anetarët e Komisioni


Adelina Kajtazi-Kryesuese



Fitore Gashi -Anëtare



Shqipe Arifaj-Anëtare



Leonora Selmani -Anëtare



Rexhep Gojnovci-Anëtar

